



**FAKULTETI  
JURIDIK**

**PROGRAMI STUDIMOR PËR STUDIME PASUNIVERSITARE**

**(Master of Arts)**

**TITULLI I PROGRAMIT:**

**STUDIME PËR TË DREJTËN CIVILE**

**HYRJE**

**FAKULTETI JURIDIK**

<b>1. Institucioni/organi për dhënien titullit</b>	Universiteti i EJL-së
<b>2. Institucioni arsimor</b>	Universiteti i EJL-së
<b>3. Vendi i mbajtjes së mësimit</b>	Kampusi i UEJL-së (Tetovë)
<b>4. Program i akredituar nga:</b>	Këshilli i akreditimit
<b>5. Grada finale shkencore</b>	M.A.
<b>6. Programi</b>	Studime për të drejtën civile
<b>7. Data e përpunimit/revizionit</b>	Shtator 2007
<b>8. Grupi i studentëve</b>	Gjenerata e vitit akademik 2008/2009

10. Pas mbarimit të programit, studentët do të pajisen me njohuri dhe do t'i kuptojnë të gjitha sferat e së drejtës civile, siç janë: e drejta civile materiale, e drejta sendore, procedura civile, e drejta detyrimore, e drejta familjare dhe e drejta trashëgimore, e drejta private evropiane, e drejta e pronësisë industriale, e drejta tregtare, e drejta fiskale dhe të ngjashme, si dhe për rregulla qenësore, relevante për fushat kyçe të së drejtës civile, perspektivat teorike dhe debatet akademike, të cilat në mënyrë qenësore i vënë në dukje fushat juridike, aspektet kyçe, problemet politike dhe parimet e ndërlidhura me funksionimin e institucioneve të shtetit në lidhje me të drejtën private;

**11. Studentët do të aftësohen:**

- me sukses t'i zbatojë njohuritë e fituara nga e drejta civile në shumë situata ku shqyrtohen problemet relevante praktike ose teorike;
- t'i vlerësojë problemet në bazë të kontekstit, relevancës dhe rëndësisë të tyre dhe t'i ndërlidh informacionet relevante dhe burimet kyçe nëpërmjet mjeteve elektronike ose mjeteve tjera;
- t'i vlerësojë problemet dhe të gjejë zgjidhje për lidhur me zbatimin e të drejtës civile në shtet, t'i formulojë argumentet për problemet kryesore dhe sferat kontraverze dhe të prezantojë mendim racional të bazuar në materiale relevante;
- t'i njohë argumentet potenciale alternative dhe dëshmitë kundërthënëse sipas mendimit të vetë dhe t'i prezantojë;
- Të demonstrojë mendimin e lirë dhe aftësi për të ofruar nxitje kritike për njohuritë e fituara për probleme individuale;
- të jetë konstruktiv në progresin shkencor.

**12. Rezultati e nxënies së mësimit**

Cikli i dytë i programit për të drejtën civile do të ofrojë njohuri solide dhe kuptim sistematik për strukturat institucionale, parimet kyçe juridike dhe kontekstet e caktuara të së drejtës civile.

<p><b>Njohuritë e fituara</b></p>	<p><b>Ligjëratat/mësimi, metodat dhe strategjitë e vlerësimit të cilat përdoren për arritjen dhe prezantimin e rezultateve</b></p>
<p><b>A. Njohuritë e fituara dhe shqyrtimet:</b></p> <p>1. Programi i nxit studentët të japin komente origjinale dhe të avancuara, të cilat do t'i plotësojnë standardet e larta shkencore dhe ju ndihmojnë studentëve në zhvillimin e shkathtësive kritike, analitike dhe hulumtuese që mund të aplikohen në shumë fusha.</p> <p>2. Programi është strukturuar me qëllim të zhvillimit të shkathtësive në sferën e hulumtimeve juridike akademike, posaçërisht përmes prezantimit me shkrim të argumenteve në frymën në të cilën i integron rregullat relevante akademike dhe t'ju ndihmojë studentëve, të cilët mendojnë në vazhdimin e hulumtimeve të tyre akademike në nivel më të lartë, me qëllim të krijimit të një baze të mirë në lidhje me teknikat e domosdoshme dhe metodat hulumtuese, të cilat janë pjesë e lëndëve të specializimit.</p> <p>3. Ky program do t'ju mundësojë studentëve kualifikime të vlefshme pasuniversitare, sidomos atyre që kanë për qëllim të marrin rolin udhëheqës në procesin e reformave në gjyqësi, përgatitjen e ligjeve dhe dhënin e shërbimeve qytetarëve në sferën e së drejtës civile dhe së drejtës sendore. luftës kundër kriminalitetit dhe</p>	<p><b>Ligjëratat/mësimi</b></p> <p>Ligjëratat do të ndiqen nëpërmjet tri orëve të seminare, të cilat do të mbahen çdo të ditën javë. Në fillim të ligjëratave, ligjëruesi do ta paraqes kontekstin e përgjithshëm të lëndës dhe ekspozenë e problemeve kyçe dhe do t'i vë në dukje sferat për të cilat do të diskutohet në të ardhmen. Këtë hyrje që do ta gjejnë studentët në literaturën e rekomanduar, ka për qëllim t'i fokusojë seminarët në diskutime të hollësishme për tema të caktuara, thjeshtë të bazuara në prezantime dhe ese nga ana e studentëve dhe aplikimi i diskutimeve për probleme kritike. Prezantimet kërkojnë nga studentët të formojnë pikëpamjet e tyre për fushën përkatëse dhe të zhvillojnë diskutime me ligjëruesin dhe me kolegët.</p> <p><b>Vlerësimi</b></p> <p>Vlerësimi i njohurive të fituara nga lëndët dhe kombinimi provimeve me shkrim (kolokuiume dhe provimi final) esetë e përbërë prej 4000 deri më 500 fjalë, të cilat patjetër duhet të dorëzohen për çdo lëndë të ndjekur, kolokuiumi dhe provimi final. Pjesa tjetër e programit kërkon nga studentët të hulumtojnë, të shkruajnë dhe ta dorëzojnë disertacionin e bërë prej 15.000 deri më 20.000 fjalë, pas caktimit paraprak të temës nga fusha e së drejtës civile dhe nën mbikëqyrjen e një anëtari të kuadrit akademik me përvojë nga fusha përkatëse.</p>

**B. Shkathtësitë dhe karakteristikat tjera**

**Aftësitë për bartjen e shkathtësive Ligjëratat/mësimi  
intelektuale.**

**Pas kryerjes me sukses të programit  
studentët mund:**

1. Të fitojnë shkathtësi për t'u ballafaquar me problemet juridike në lidhje me kontestet pronësore, marrëdhëniet juridiko-familjare, marrëdhëniet juridike të trashëgimisë dhe të ngjashme, dhe ta zhvillojnë vetëdijen kritike për funksionimin e e institucioneve të së drejtës private.

2. Ta zhvillojnë vetëdijen kritike për funksionimin e institucioneve të së drejtës private.

3. Ta vazhdojnë karrierën e tyre në të drejtën penale në nivel akademik dhe në nivel praktik.

Shkathtësitë e numëruara intelektuale zhvillohen para së gjithash nëpërmjet përgatitjes dhe pjesëmarrjes në seminare, dhe shumë pak përmes leksioneve formale. Kjo mundëson që politikat dhe interpretimet e ndryshme të së drejtës të studiohen në mënyrë kritike, kurse pozicionet alternative të vlerësohen në mënyrë krahasimtare.

Prezantimi i seminareve mund në mënyrë të plotë të orientohet në ato sfera, të cilat lejojnë hapësirë për diskutim dhe debate dhe për të cilat ekziston interes përkatës. Në vazhdim, vlerësimi i lëndës i lejon dhe i nxit diskutimet dhe prezantimet e avancuara të cilat janë në pajtueshmëri me rregullat e shprehjes akademike.

<b>C. Aplikimi i shkathtësive speciale:</b>	<b>Ligjëratat/mësimi</b>
<b>Aplikimi dhe zgjidhja e rasteve juridike</b>	
Pas përfundimit me sukses të programit, studentët do të mund:	
a) Me hulumtimin dhe përgatitjen e disertacionit t'i zhvillojnë shkathtësitë hulumtuese. Mbikëqyrja gjatë përgatitjes së disertacionit ju mundëson studentëve të mendojnë në mënyrë individuale dhe progresive;	<b>Vlerësimi</b> <i>Aftësia për zgjidhjen e problemeve juridike kryesisht zhvillohet përmes përgatitjes dhe pjesëmarrjes në orët e këtij programi.</i>
b). Të zhvillojnë një nivel të lartë përmes disertacioneve të tyre dhe, njëkohësisht ju mundëson që shkathtësitë e ndryshme të studentëve të vinë në shprehje bashkë me punimin e shkruar të magjistraturës;	Pas seminareve të mbajtura në gjuhën angleze nga ana e kuadrit ndërkombëtar për së afërmi njihen me metodat mësimore juridike të lejuara në vendet e Europës Perëndimore dhe universitetet amerikane.
c) T'i identifikojnë rastet në bazë të përvojave të mëhershme juridike;	<b>Vlerësimi</b> Vlerësimi bëhet në pyetjet e shtruar rreth lëndës konkrete në provimin me shkrim dhe në vlerësimin e lëndës, duke i përfshirë edhe testet në orë.
ç) Të mendojnë për shkakun dhe të jenë të informuar mirë për veprimet e mundshme ligjore, të cilat rrjedhin nga ky mendim, si dhe nga mundësitë e suksesit.	

**Ç) Burimet, hulumtimet, dhe vlerësimi**  
**Pas përfundimit me sukses të**  
**programit, studentët do të mund:**

**Ligjëratat/mësimi**

**Vlerësimi**

a) Ta vazhdojnë karrierën e tyre në sferën e së drejtës civile në nivelin akademik dhe në nivelin praktik;

Vlerësimi i lëndës dhe disertacionit.

b) T'i identifikojnë çështjet juridike dhe çështjet tjera që duhet të hulumtohen;

c) T'i shfrytëzojnë në mënyrë efikase burimet sekondare dhe primare;

ç) Të bëjnë hulumtime të pavarura juridike, duke shfrytëzuar një varg burimesh;

) T'i vlerësojnë në mënyrë kritike sferat e së drejtës civile, si nga aspekti i doktrinës, po ashtu edhe nga aspekti shoqëror;

dh) Të zhvillojnë nivel të lartë, të sofistikuar shkencor përmes tezave të tyre, dhe njëkohësisht, mundëson që shkathhtësitë e ndryshme të studentëve të vijnë në shprehje në tezën e shkruar të magistraturës.

**D. Shkathtësitë themelore:**

**Komunikimi dhe shkrimi**

Pas kryerjes së programit me sukses, studentët aftësohen:

a) Të fitojnë shkathtësi të vlefshme komunikuese, posaçërisht ata të cilët janë të interesuar për punësim, pas mbarimit të studime pasuniversitare në sferën e jurisprudencës dhe të avokaturës.

b) Ta shfrytëzojnë gojarisht/me shkrim gjuhën shqipe, maqedonase dhe angleze, lidhur me çështjet rreth sferës së të drejtës civile;

c) Të angazhohen në mënyrë efikase dhe konstruktive në dëshmitë dhe diskutimet për çështjet komplekse në gjuhën shqipe, maqedonase dhe në gjuhën angleze;

ç) Të bëjnë prezantimin e qartë dhe koherent për ndonjë temë ose detyrë, duke përdorur materiale të ndryshme;

d) Të lexojnë materiale komplekse të cila janë ose nuk janë të lidhura me sferën e së drejtës civile.

**Ligjëratat/mësimi**

Punimet e seminarit, prezantimet në orë, diskutime. Përgatitjet, të shkruarit dhe reflektimi nga vlerësimi i lëndës së shkruar, duke i përfshirë edhe disertacionet.

**Vlerësimi**

Vlerësimi i lëndës së shkruar, vlerësimi i prezantimeve në orë, si dhe realizimi i punës së vlerësuar praktike. Provimi me gojë dhe me shkrim.

**11. Struktura e programit studimor, kushtet e studimit, niveli, moduli, kreditë**

Studime pasuniversitare nga fusha e së drejtës civile do të zgjasin (2) vite akademike, përkatësisht tre semestra, të përbërë nga pesë lëndë dhe një semestër teza e magjistraturës. Lëndët në semestra janë të obligueshme, ndërsa të tjerat janë zgjedhore. Çdo lëndë e dëgjuar, dhe me sukses është kaluar në provim, studentit do t'i sjell 6 (gjashtë) kredi, kurse teza e magjistraturës do t'i sjell 30 kredi. Kjo donë të thotë se për kryerjen me sukses të studimeve pasuniversitare janë të nevojshëm 120 kredi. Secila lëndë duhet të kryhet duke i plotësuar edhe kërkesat e shtruara në silabusin (programin) e lëndës.

CIKLI I DYTË I STUDIMEVE PËR TË DREJTËN CIVILE

PROGRAMI STUDIMOR PËR STUDIME PASUNIVERSITARE PËR TË DREJTËN CIVILE

<i>Semestri 1</i>	<i>Kreditë</i>	<i>Dimëror/ Veror</i>	<i>Orët teorike</i>	<i>Orët praktike</i>	<i>Gjithsej Orët studimore</i>	<i>Madhësia e grupeve</i>
Gjuha angleze	6	D	22	22	180	
Metodologjia e së drejtës	6	D	22	22	180	
E drejta civile	6	D	22	22	180	
E drejta sendore	6	D	22	22	180	
Lënda zgjedhore	6	D	22	22	180	
<b>Gjithsej</b>	<b>30</b>				<b>900</b>	

<i>Semestri 2</i>	<i>Kreditë</i>	<i>Dimëror/ Veror</i>	<i>Orët teorike</i>	<i>Orët praktike</i>	<i>Gjithsej Orët studimore</i>	<i>Madhësia e grupeve</i>
E drejta detyrimore	6	V	22	22	180	
E drejta familjare	6	V	22	22	180	
E drejta private europiane	6	V	22	22	180	
E drejta e trashëgimisë	6	V	22	22	180	
Lënda zgjedhore	6	V	22	22	180	
<b>Gjithsej</b>	<b>30</b>				<b>900</b>	

<i>Semestri 3</i>	<i>Kreditë</i>	<i>Dimëror/ Veror</i>	<i>Orët teorike</i>	<i>Orët praktike</i>	<i>Gjithsej Orët studimore</i>	<i>Madhësia e grupeve</i>
E drejta private ndërkombëtare	6	D	22	22	180	
E drejta civile procedurale	6	D	22	22	180	
E drejta tregtare	6	D	22	22	180	
E drejta fiskale	6	D	22	22	180	
Lënda zgjedhore	6	D	22	22	180	
<b>Gjithsej</b>	<b>30</b>				<b>900</b>	

<i>Semestri 4</i>	<i>Kreditë</i>	<i>Dimëror/ Veror</i>	<i>Orët teorike</i>	<i>Orët praktike</i>	<i>Gjithsej Orët studimore</i>	<i>Madhësia e grupeve</i>
-------------------	----------------	---------------------------	---------------------	----------------------	--------------------------------	---------------------------

## CIKLI I DYTË I STUDIMEVE PËR TË DREJTËN CIVILE

Shkrimi i tezës	30	V			900	
<b>Gjithsej</b>	<b>30</b>				<b>900</b>	

### Lëndët zgjedhore:

- Arbitrazhi ndërkombëtar
- E drejta e falimentimit
- E drejta e pronësisë industriale
- E drejta e krahasuar

**PËRSHKRIMI I LËNDËVE OBLIGATIVE**

**SEMESTRI 1**

**Metodologjia e së drejtës**

Metodologjia e së drejtës i studion metodat e njohjes së të drejtës dhe dhe llojet e saj, si dhe metodat e krijimit, interpretimit dhe zbatimit të së drejtës, që janë të nevojshme për procesin hulumtues në të gjitha sferat juridike dhe në të gjitha nivelet e arsimimit akademik.

**E drejta civile**

Lënda e drejta civile, më parë e studion bazën e të drejtës civile, pastaj i studion dhe i analizon institutet civilo-juridike të paraparë me sistemin juridik të Republikë së Maqedonisë. Kjo e ndjek zhvillimin e këtyre instituteve në të drejtën tonë dhe ndryshimet bashkëkohore të tyre, duke vënë në pah rëndësinë e këtyre instituteve si bazë të çdo praktike juridike.

**E drejta sendore**

Kjo lëndë i analizon institutet sendoro-juridike që aplikohen në të drejtën tonë. Me këtë rast. Në mënyrë të hollësishme përpunohet Ligji i pronës dhe të drejtat tjera sendore. Lënda posaçërisht përqendrohet në institucionet e hipotekës, pengut, dhe të ngjashme, duke vënë një bazë juridike për punë të mëtejshme praktike të studentëve në këtë sferë.

**SEMESTRI 2**

**E drejta detyrimore**

Lënda e drejta detyrimore i përfshinë të drejtën e kontratës dhe deliktet civilo-juridike. I analizon parimet themelore të së drejtës kontraktuese dhe, me këtë rast, në hollësi i studion kontratat që janë në qarkullimin juridik në Republikën e Maqedonisë, duke i vënë dukje karakteristika e tyre, kushtet e bërjes së kontratës dhe kushtet e zgjidhjes së kontratës dhe të ngjashme.

Deliktet civilo-juridike vihen në dukje në mënyrë të hollësishme, me të gjitha institucionet, siç janë dëmi, fitimi i pa bazë dhe kështu me radhë.

**E drejta familjare**

## **CIKLI I DYTË I STUDIMEVE PËR TË DREJTËN CIVILE**

Kjo lëndë i studion marrëdhëniet familjaro-juridike, të drejtën martesore dhe të drejtën prindërore. Pas një vështrimi të shkurtër historik për llojet e familjeve gjatë historisë, lënda fokusohet në tema bashkëkohore, përkatësisht në gjendjen në Republikën e Maqedonisë në lidhje me këto marrëdhënie. Kjo është një degë e veçantë e drejtësisë, e cila në mënyrë të hollësishme e studion se cila është korniza juridike për vënien e kurorëzimit, për zgjidhjen e kurorës, për fitimin dhe humbjen e të drejtës familjare, të kujdestarisë dhe të ngjashme.

### **E drejta private europiane**

Lënda E drejta private evropiane i studion dhe analizon dokumentet juridike të Unionit Europian, m të cilat rregullohen sferat e të drejtës private dhe dinamika e zhvillimit të saj.

### **E drejta e trashëgimisë**

Lënda E drejta e trashëgimisë i përfshinë marrëdhëniet trashëgimoro-juridike që krijohen midis trashëgimlënësit dhe trashëgimtarit. Kjo lëndë i përshkruan rregullat juridike të cilat i rregullojnë këto marrëdhënie.

## **SEMESTRI 3**

### **E drejta private ndërkombëtare**

E drejta private ndërkombëtare si degë juridike e sistemit pozitiv juridik të një shteti të caktuar i rregullon marrëdhëniet privato-juridike me element të huaj dhe i parashikon mënyrat e rregullimit të tyre. Me këtë rast, burimet kombëtare dhe ndërkombëtare për rregullimin këtyre marrëdhënieve, si dhe hierarkinë e burimeve nga aspekti i prioriteteve të zbatimit të tyre për rregullimin e marrëdhënieve që përmes subjektit ose objektit, ose të drejtat dhe obligimet janë të ndërlidhura me sovranitetin e shteteve të huaja. Gjithashtu, kjo lëndë jep njohuri përmbajtjesore për tërësitë që e formojnë këtë degë të së drejtës, përkatësisht tërësinë e të drejtave civile që shtetasit e huaj të mund që në territorin e shtetit vendës të themelojnë marrëdhënie privato-juridike me element të huaj; tërësinë e të drejtave civile që shtetasit (vendësit) të mund të themelojnë marrëdhënie civilo-juridike me element të huaj, tërësinë e kolizionit të juridiksionit, si dhe tërësinë e kolizionit të ligjeve.

### **E drejta civile procedurale**

E drejta civile procedurale i studion rregullat të cilat e rregullojnë procedurën midis qytetarëve në kontest për marrëdhënie sendoro-juridike dhe obligativo-juridike, e

## **CIKLI I DYTË I STUDIMEVE PËR TË DREJTËN CIVILE**

rregullojnë aplikimin e mjeteve juridike dhe të ngjashme. Lënda përfshinë: procedurën hetimore, procedurën jashtëkontestimore, dhe procedurën ekzekutive.

### **E drejta tregtare**

Lënda e Drejta tregtare i studion marrëdhëniet tregtaro-juridike midis subjekteve tregtare: tregtar - individ, dhe tregtar – shoqëri. Gjithashtu, e drejta tregtare i studion edhe marrëdhëniet të cilat krijohen në momentin e dhënies së letrave me vlerë deri në momentin e realizimit të tyre. Në këtë lëndë studiohen edhe kontratat tregtare, si dhe të drejtat e pronësisë industriale.

### **E drejta fiskale**

Lënda e drejta fiskale e studion të drejtën fiskale si degë e veçantë e sistemit juridik. I studion marrëdhëniet fiskalo-juridike, si marrëdhënie publiko-juridike, për shkak se nga njëra anë si subjekt gjithmonë paraqitet shteti, përkatësisht organet shtetërore, ndërsa nga ana tjetër si subjekte paraqiten personat fizik dhe juridik në cilësinë e obliguesit tatimor, obligues doganor etj.

## **PËRSHKRIMI I LËNDËVE ZGJEDHORE**

### **Arbitrazhet ndërkombëtare**

Kjo lëndë i analizon problemet në tregtinë ndërkombëtare dhe marrëdhëniet ekonomike me karakter ndërkombëtar dhe zgjidhjen e tyre në nivelin ndërkombëtar përmes gjyqeve ndërkombëtare të arbitrazhit.

### **E drejta e falimentimit**

Kjo lëndë e studion të drejtën e falimentimit në Republikën e Maqedonisë, me këtë rast edhe analizat e situatave në shtet lidhur me falimentimin dhe realizimin e tij përmes organeve gjyqësore.

### **E drejta e pronësisë industriale**

E drejta e pronësisë industriale i studion rregullat juridike, të cilat vlejné në sferën e patenteve dhe të pronësisë industriale, duke i analizuar rrjedhat zhvillimore të kësaj dege të së drejtës, e cila është në zhvillim e sipër.

### **E drejta krahasimtare**

Lënda e drejta krahasimtare fillon me analizën historike të së drejtës krahasimtare si shkencë, kurse vazhdon me definicionin dhe aplikimin e saj bashkëkohor, që në fund ta prezantojë sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë si pjesë të familjeve dhe sistemeve globale juridike, siç është sistemi kontinental, anglosakson dhe sistemet tjera juridike, si p.sh. sistemi religjioz dhe sistemet e përziera juridike. Kjo analizë bëhet në bazë të së

## **CIKLI I DYTË I STUDIMEVE PËR TË DREJTËN CIVILE**

drejtës private dhe ligjeve civile. Gjithashtu, lënda i vë në dukje burimet e ndryshme të së drejtës në sisteme të ndryshme juridike dhe në institucionet e tyre, duke bërë dallim midis profesioneve juridike në sistemet e ndryshme juridike.